



QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**RAPORT MBI PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER
PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË
DYTË.**

VITI AKADEMIK 2018-2019

TIRANË, Dhjetor 2018

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE	1
RAPORT MBI PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË.	1
VITI AKADEMIK 2018-2019.....	1
Parathënie.....	3
Shënime për raportin.....	4
Kreu I.....	6
Procesi i Aplikimit dhe Pranimeve në nivel kombëtar	6
Kreu II	7
Regjistrimet në nivel sistemi shkollimi (IAL publike/jopublike).	7
Kreu III	8
Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL-je	8
Kreu IV.....	11
Regjistrimet sipas kuotave.....	11
Kreu V.....	15
Raporti kuota – kërkesa nga aplikantët në nivel IAL.....	15
Kreu VI.....	19
Procesi i aplikimeve dhe regjistrimeve në nivel program studimi	19
Kreu VII.....	20
Regjistrimet sipas gjinisë dhe urbanizimit	20
Kreu VIII.....	22
Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL.....	22
Kreu IX.....	26
Cilësia e studentëve të regjistruar sipas gjinisë dhe urbanizimit.....	26
Kreu X.....	27
Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notave mesatare	27
Kreu XI.....	35
Procesi i pranimit në programet e studimit që mund të profilizohen mësuesi.....	35
Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi	35
Kuota të regjistruar në nivel IAL për programe që mund të profilizohen mësuesi.	38
Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e mësuesisë	40
Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notave mesatare	43

Parathënie

Ky raport ka për qëllim, jo vetëm të të pasqyrojë procesin e aplikimeve dhe regjistrimeve në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2018-2019, në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), por edhe të orientojë më qartësisht vendimmarrësit në fushën e arsimit, maturantët dhe kandidatët për studentë gjatë përzgjedhjes së tyre për programet e studimit që ofrohen nga Institucionet e Arsimit të Lartë, IAL-të publike dhe jopublike në hartimin e strategjive më të mira për ndërtimin e kurrikulave dhe programeve të reja të studimeve, për informimin e maturantëve dhe kandidatëve rreth programeve të studimit që ofrojnë dhe si dhe orientimin e tyre në tregun e punës në të ardhmen.

Gjithashtu, synohet një ndërgjegjësim më i mirë i kandidatëve për student, për t'u fokusuar më mirë në ato programe studimi, ku ata mund të arrijnë potencialin e tyre maksimal dhe ku kanë më shumë mundësi të pranohen.

Meqenëse kriteret e pranimit, të vendosura nga IAL-të, mbështeten kryesisht në arritjet e maturantëve dhe kandidatëve në arsimin e mesëm të lartë si dhe duke qenë ky filtri kryesor hyrës në IAL, mund të themi se, tërheqja e studentëve cilësorë në hyrje është një faktor i rëndësishëm që përcakton edhe cilësinë në vijueshmërinë e studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky material jep informacion mbi aplikantët dhe studentët e pranuar në IAL, si edhe nivelin e studentëve hyrës sipas kriterit të notës mesatare. Në të, informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që bën të mundur, jo vetëm njohjen e cilësisë të studentëve të pranuar në nivel kombëtar, por edhe në nivel IAL-je dhe programi studimi.

Gjithashtu ky raport bën edhe një pasqyrim të procesit të pranimeve në vitin akademik 2018-2019 për programet e studimit të cilat mund të profilizohen në mësuesi.

Materiali jep informacion mbi aplikantët dhe studentët e pranuar në IAL, si edhe nivelin e studentëve hyrës sipas kriterit të notës mesatare. Në të, informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që bën të mundur, jo vetëm njohjen e cilësisë të studentëve të pranuar në nivel kombëtar, por edhe në nivel IAL-je dhe programi studimi për ato programe studimi të cilat mund të profilizohen në mësuesi.

Shënime për raportin

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e të dhënave e krijuar nga QSHA për:

- Realizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2018.
- Mbledhjen e të dhënave për arsimin e mesëm të lartë nga shkollat dhe përllogaritjen e notës mesatare sipas VKM Nr. 216, date 20.04.2018 për çdo maturant aplikues.
- Kuotat e verifikuara dhe certifikuara nga Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë për kategorinë shqiptarë brenda vendit.
- Aplikimin deri në dhjetë përzgjedhje të çdo maturanti dhe kandidati për studime në IAL.
- Regjistrimet e studentëve nga sekretaritet mësimor të IAL-ve në portalin U-Albania për vitin akademik 2018-2019 (cikli i parë i studimeve për kategorinë shqiptarë brenda vendit).

Maturantët dhe kandidatët aplikuan në Portalin U-Albania, në tre raunde aplikimi duke përzgjedhur deri në 10 preferenca si dhe kryen regjistrimin në tre raunde pasuese në Portalin U-Albania për pranimet në ciklin e parë të studimeve të vitit akademik 2018-2019.

Vëmë në dukje se në tre vitet e fundit akademike 2016-2017, 2017-2018 dhe 2018-2019, mbështetur në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, u përcaktua si kriter aplikimi e pranimi në Institucionet e Arsimit të Lartë në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, nota mesatare minimale 6. Gjithatë për programet e studimit, të cilat profilizohen në mësuesi, nota mesatare minimale është 7. Kjo notë do të përllogaritej si mesatare aritmetike e thjeshtë e dy treguesve:

1. Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit të arsimit të mesëm të lartë
2. Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

Po sipas këtyre vendimeve, për programet e studimit dyvjeçare me karakter profesional, nuk ishte detyrim kriteri i notës mesatare 6 sipas përcaktimit të mësipërm.

Lidhur me të dhënat për procesin e pranimi në programet e studimit të mësuesisë, informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e regjistrimeve të ciklit të parë të regjistrimeve viti akademik 2018-2019 për programet e studimit të cilat mund të profilizohen mësuesi.

Profilët për të cilat jepet provim shteti për profesionin e rregulluar të mësuesit dhe të cilat janë objekti i studimit renditen si më poshtë:

1	Artet Figurative
2	Biologji
3	Biologji - Kimi
4	Edukim Fizik dhe Sporte
5	Filozofi
6	Fizikë
7	Gjeografi
8	Gjuhe angleze
9	Gjuhë Frënge
10	Gjuhë Gjermane
11	Gjuhë Greke
12	Gjuhe italiane
13	Gjuhë-Letërsi
14	Histori
15	Informatike
16	Instrumentat muzikore
17	Kimi
18	Matematikë
19	Matematikë - Fizikë
20	Matematikë Informatikë
21	Mësuesi për Arsimin Fillor
22	Pedagogji e specializuar
23	Psikologji
24	Sociologji

Të gjithë programet e studimit të cilat mund të profilizohen në mësuesi në këtë vit akademik kishin notë mesatare 7 si kriter pranimi.

Kreu I

Procesi i Aplikimit dhe Pranimeve në nivel kombëtar

Në nivel kombëtar, gjatë vitit akademik 2018-2019, u ofruan:

- **517** programe studimi, nga të cilat:
 - **304** nga IAL-të publike;
 - **213** nga IAL-të jopublike;

Programe të studimit dyvjeçare me karakter profesional u ofruan gjithsej **63** të tilla nga të cilat:

- **25** nga IAL-të publike;
- **38** nga IAL-të jopublike;

Për programet e studimit të ciklit të parë, ato 2 vjeçar me karakter profesional dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë për kategorinë shqiptarë brenda vendit, për këtë vit akademik, në tërësi u ofruan:

- **38624** kuota nga të cilat:
 - **24734** kuota nga IAL-të publike;
 - **13890** kuota nga IAL-të jopublike;

Në programet e studimit të ofruara për vitin akademik 2018-2019 **aplikuan** gjithsej në raundin e parë:

- **24426** aplikantë, prej të cilëve u regjistruan në të gjitha IAL-të publike dhe jopublike për kategorinë shqiptarë brenda vendit.

Në programet e studimit të ofruara për vitin akademik 2018-2019 **u regjistruan** gjithsej në të treja raundet:

- **22253** të regjistruar nga të cilat:
 - **17535** të regjistruar në IAL-të publike;
 - **4718** të regjistruar në IAL-të jopublike;

Shenim : Studentët e regjistruar, në bazë të Udhëzimit nr 33.datë 23.10.2018 nuk janë përfshirë në këtë Raport Publik pasi përpunimi i tyre kërkon një kohë relativisht më të gjatë në nxjerrjen e këtij raporti.

Kreu II

Regjistrimet në nivel sistemi shkollimi (IAL publike/jopublike).


Regjistrimet në IAL-të publike dhe jopublike, krahasuar me regjistrimet në total, pasqyrojnë një shpërndarje në përqindje, të paraqitur në **grafikun 1** të mëposhtëm.

IAL-të publike zënë pjesën më të madhe të regjistrimeve **me:**

- **79 %** të tyre.

Pjesa më e madhe e regjistrimeve të studentëve vazhdon të jetë e orientuar drejt IAL-ve publike.

Grafik 1. – Regjistrime në nivel sistem shkollimi (publik/jopublik)



Kreu III

Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL-je

Tabela 1 tregon se sa studentë u regjistruan në çdo Institucion të Arsimit të Lartë, e shprehur kjo në përqindje ndaj totalit të regjistrimeve në nivel kombëtar për vitin akademik 2018-2019.


Tabela 1 – Regjistrime në nivel IAL

Universitete Publike dhe Jopublike	Shpërndarja e regjistrimeve në rang IAL
UNIVERSITETI I TIRANËS	23.17%
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS	10.37%
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	8.30%
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	7.75%
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	7.26%
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	5.12%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	4.66%
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË	4.39%
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	3.89%
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	2.87%
UNIVERSITETI ALDENT	2.21%
UNIVERSITETI EPOKA	2.18%
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	2.17%
UNIVERSITETI "MESDHETAR I SHQIPËRISË"	1.65%
UNIVERSITETI "EQEREM CABEJ" GJIROKASTËR	1.46%
UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"	1.35%
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	1.34%
UNIVERSITETI MARIN BARLETI	1.33%
KOLEGJI UNIVERSITAR LUARASI	1.15%
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	0.96%
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	0.91%
UNIVERSITETI POLIS	0.76%
KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"	0.63%
KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS	0.61%
KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"	0.58%
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY (TBU)	0.47%
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	0.45%
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	0.45%
KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"	0.44%
KOLEGJI UNIVERSITAR "Logos"	0.33%

Universitete Publike dhe Jopublike	Shpërndarja e regjistrimeve në rang IAL
KOLEGJI UNIVERSITAR ĖISDOM	0.29%
KOLEGJI UNIVERISTAR "REALD"	0.28%
Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë"	0.06%
TESS (TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL)	0.04%
SHKOLLA E LARTË "NEHEMIAH GATEËAY"	0.03%
AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI	0.02%
Akademia "IVODENT"	0.02%
EPITECH (EUROPEAN INSTITUTE OF INFORMATION TECHNOLOGY)	0.02%

Nga tabela rezulton se, numri më i madh i studentëve të regjistruar, i përket:

- **Universitetit të Tiranës** me **23.17%**, i cili gjithashtu ofron numrin më të madh të kuotave 5545 në 36 programe studimi.
- **Universiteti i Durrësit** me **10.37%** të studentëve të regjistruar, i cili vjen i treti në listë për nga numri i kuotave të ofruara 2981 të tilla në 45 programe studimi.



Grafik 2 - Regjistrimet sipas Institucioneve të Arsimit të Lartë

Kreu IV


Regjistrimet sipas kuotave

Nga totali i kuotave, janë plotësuar me regjistrime 57.61%, për vitin akademik 2018-2019.

Rezulton se, janë plotësuar me regjistrime në:

- IAL-të publike **70.89 %** e kuotave.
- IAL-të jopublike **33.97 %** e kuotave.

Grafik 3: Kuota të plotësuar me student të regjistruar në nivel sistemi institucionesh publike/jopublike.



Nisur nga përqindja më e lartë e konsumit të kuotave në IAL-të publike shohim se pjesa më e madhe e studentëve preferojnë të regjistrohen në këto IAL.

Plotësimi i kuotave me regjistrime për çdo Institucion të Arsimit të Lartë

Përpunimi i të dhënave, që tregon plotësimin e kuotave me studentë të regjistruar për çdo IAL paraqitet në tabelën e mëposhtme (Tabela 2).

Përqindjen më të lartë të plotësimit të kuotave të ofruara në Universitetet Publike e zë:

- **Universiteti i Sporteve të Tiranës** me 100% i cili ka edhe specifikën e zhvillimi të konkurseve të pranimit, sipas disiplinave, ku aplikantët paraqesin aftësi nga ana përgatitjes sportive.
- **Universiteti i Mjekësisë** me 100 % të kuotave të plotësuara;
- Universiteti Politenik i Tiranës me 95.71 % të kuotave të plotësuara;
- Universiteti i Tiranës me 93.18 % të kuotave të plotësuara.;


Përqindjen më të lartë të plotësimit të kuotave të ofruara në Universitetet JoPublike e zë:

- TIRANA BUSINESS UNIVERSITY (TBU) me 100 % të kuotave të plotësuara;
- UNIVERSITETI ALDENT me 83.39 % të kuotave të plotësuara;

Tabela 2 - Plotësimi i kuotave në nivel IAL-je.

Nr	Universitetet Publike dhe JoPublike	Kuota të plotësuar në nivel IAL-je
1	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	100%
2	UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	100%
3	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	95.71%
4	UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	83.13%
5	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS	77.59%
6	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	70.34%
7	UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	54.23%
8	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	50.93%
9	UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË	46.96%
10	UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	43.70%
11	UNIVERSITETI "EQEREM CABEJ" GJIROKASTËR	39.88%
12	TIRANA BUSINESS UNIVERSITY (TBU)	100%
13	UNIVERSITETI I TIRANËS	93.18%
14	UNIVERSITETI ALDENT	83.39%
15	UNIVERSITETI EPOKA	67.69%
16	SHKOLLA E LARTË "NEHEMIAH GATEËAY"	63.64%
17	KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"	60.75%
18	UNIVERSITETI "MESDHETAR I SHQIPËRISË"	57.50%
19	UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"	53.14%
20	UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	48.38%
21	UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA	46.98%
22	UNIVERSITETI POLIS	45.95%
23	UNIVERSITETI MARIN BARLETI	41.87%
24	KOLEGJI UNIVERSITAR LUARASI	41.83%
25	KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	34.40%
26	AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI	31.25%
27	KOLEGJI UNIVERISTAR "REALD"	25.62%
28	KOLEGJI UNIVERSITAR ËISDOM	25.49%
29	KOLEGJI UNIVERSITAR "Logos"	25.00%
30	UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	24.99%
31	Akademia "IVODENT"	20.00%
32	KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS	16.57%
33	KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"	13.45%
34	KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"	12.54%
35	UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	10.25%
36	Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë"	5.71%
37	TESS (TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL)	5.63%
38	EPITECH (EUROPEAN INSTITUTE OF INFORMATION TECHNOLOGY)	4.44%

Grafiku 4 - Kuotat e plotësuara sipas Institucioneve të Arsimit të Lartë.



Kreu V

Raporti kuota – kërkesa nga aplikantët në nivel IAL

Një qasje tjetër, në lidhje me kuotat e ofruara në nivel IAL-je, është edhe raporti midis kuotave të vendosura në dispozicion nga IAL-të krahasuar me kërkesat nga ana e aplikantëve.

Maturantët dhe kandidatët kishin të drejtë të përzgjedhin deri në dhjetë programe të ndryshme studimi.

Aplikantët, të cilët nuk u regjistruan në raundin e parë, patën të drejtë ri aplikimi, ku mund të përzgjidhnin të njëjtat programe studimi apo programe të tjera.

Kështu, për të përcaktuar numrin e aplikantëve për çdo IAL, është përlogaritur numri i tyre në raundin e parë.

Ndërkohë, për kuotat, kanë shërbyer si referencë ato të miratuara për kategorinë “Shqiptarë brenda vendit”.

Tabela 3 – Raporti kuota – aplikantë në % për çdo IAL.

UNIVERSITETI	Raporti Kuota -Aplikantë në nivel IAL-je
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	4.49%
UNIVERSITETI I TIRANËS	7.25%
AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI	8.38%
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	8.52%
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	11.27%
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS	11.91%
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY (TBU)	15.74%
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	16.55%
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	17.18%
UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA	23.81%
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	24.31%
UNIVERSITETI EPOKA	26.04%
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	26.85%
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË	29.64%
KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"	32.28%
UNIVERSITETI POLIS	33.42%
KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS	33.78%

UNIVERSITETI	Raporti Kuota -Aplikantë në nivel IAL-je
UNIVERSITETI ALDENT	37.04%
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	37.13%
UNIVERSITETI "MESDHETAR I SHQIPËRISË"	40.20%
UNIVERSITETI MARIN BARLETI	45.50%
UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"	46.18%
KOLEGJI UNIVERSITAR WISDOM	47.31%
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	48.00%
KOLEGJI UNIVERSITAR LUARASI	51.69%
SHKOLLA E LARTË "NEHEMIAH GATEËAY"	52.38%
KOLEGJI UNIVERISTAR "REALD"	64.19%
UNIVERSITETI "EQEREM CABEJ" GJIROKASTËR	66.86%
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	68.23%
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	75.27%
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	85.69%
AKADEMIA "IVODENT"	95.24%
EPITECH (EUROPEAN INSTITUTE OF INFORMATION TECHNOLOGY)	111.11%
KOLEGJI UNIVERSITAR "Logos"	114.29%
KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"	146.32%
KOLEGJI UNIVERSITAR "Pavarësia Vlorë"	233.33%
KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"	238.64%

Tabela paraqet sa përqind të kërkesave janë realizuar nga kuotat e vendosura në dispozicion.

P.sh. Universiteti i Mjekësisë, nisur nga numri i kuotave që ka në dispozicion për pranimet, ka realizuar vetëm % të kërkesave nga ana e aplikantëve të raundit të parë.

Si përfundim:


- Sa më e ulët përqindja aq më i lartë numri i aplikantëve në raport me kuotat. Ky mund të jetë një tregues, i cili ndihmon IAL-të që kanë një sasi të vogël kuotash dhe numër të lartë kërkesash të hartojnë politika të tilla që të përthithin numër më të lartë studentësh, duke zgjeruar kapacitetet e tyre pritëse, si edhe IAL-të që kanë kapacitete te mjaftueshme pritëse, por numër të vogël kërkesash të hartojnë politika që të tërheqin një numër më të lartë aplikantësh.

Gjithashtu nëpërmjet **grafikut 5** i cili tregon sa përqind të kërkesave, plotësohen nga kuotat e vendosura në dispozicion.

Sigurisht numri i kuotave të paplotësuara në rang IAL tregon se jo të gjitha programet kanë qenë të kërkuara sa të mos mbetej asnjë kuotë e paplotësuar. Siç e përmendëm edhe më lart, aplikantët kishin të drejtë të zgjidhin dhjetë programe studimi, në të cilat mund të regjistroheshin dhe si rrjedhojë, nëse fitonin të dhjetë programet e studimit, mund të regjistroheshin vetëm në njërin prej tyre, duke lënë të lira nëntë programet e tjera.

.

Grafik 5 – Raporti kuota –aplikantë



Kreu VI

Procesi i aplikimeve dhe regjistrimeve në nivel program studimi

20 programet e studimit më të kërkuara në raundin I të aplikimit janë paraqitur në formë tabelare si në tabelën 4.

Tabela 4- 20 programet e studimit më të kërkuara

UNIVERSITETI	PROGRAMI STUDIMIT	Kuota Shqiptarë brenda vendit 2018-2019	Kerkesa në raundin e I të aplikimit	Raporti Kuota - Aplikantë në programet më të kërkuara
UNIVERSITETI I TIRANËS	Administrim-Biznes	460	7347	6.26%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Drejtësi	700	6634	10.55%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Punë Sociale	100	5333	1.88%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Financë	460	5173	8.89%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Shkenca Politike	100	5040	1.98%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gazetari	120	4452	2.70%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë Angleze	240	4098	5.86%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Psikologji	110	3993	2.75%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë Ekonomike	250	3888	6.43%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Ekonomiks	110	3823	2.88%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	100	3691	2.71%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Administrim dhe Politika Sociale	100	3572	2.80%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Infermieri e Përgjithshme	240	3552	6.76%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e Përgjithshme	260	2877	9.04%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Fizioterapi	50	2689	1.86%
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Informatike	120	2584	4.64%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Teknikë Laboratori	50	2531	1.98%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Stomatologji	100	2487	4.02%
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Telekomunikacioni	120	2436	4.93%
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	200	2401	8.33%

Kreu VII

Regjistrimet sipas gjinisë dhe urbanizimit

Tabela 7 paraqet regjistrimet në nivel kombëtar, sipas urbanizimit fshat/qytet, sipas gjinisë femra/meshkuj, sipas sistemit publik/jopublik.

Tabela 7

	Studentë të regjistruar total	Në %	Studentë të regjistruar Publike	Në %	Studentë të regjistruar IAL Jopublike	Në %
Femra	14179	63.72%	11814	67.37%	2365	50.13%
Meshkuj	8074	36.28%	5721	32.63%	2353	49.87%
Qytet	18162	81.62%	13944	79.52%	4218	89.40%
Fshat	4091	18.38%	3591	20.48%	500	10.60%

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se për vitin akademik 2018-2019, në nivel kombëtar:

- ka më shumë studente femra.
- pjesa më e madhe e të regjistruarve janë nga zonat urbane.

Për IAL-të publike rezulton se:


- numri më i madh i të regjistruarve, 67.37%, janë femra.
- sipas urbanizimit, 79.52% e të regjistruarve në IAL-të publike vijnë nga qytetet.

Për IAL-të jopublike rezulton se:


- numri më i madh i të regjistruarve, 50.13%, janë femra .
- sipas urbanizimit, pjesa më e madhe e të regjistruarve janë nga qyteti me 89.40%.

Grafikisht shpërndarja e regjistrimeve sipas gjinisë paraqitet si në grafikët 8 dhe 9.

Grafik 8 –Regjistrime (F/M) nivel kombëtar




Grafik 9- Regjistrime femra/meshkuj sipas sistemeve IAL publike/jopublike




Paraqitja grafike e regjistrimeve sipas Urbanizimit paraqitet ne grafikët 9 dhe 10.

Grafik 9- Regjistrime(Q/F) nivel kombëtar



Grafik 10- Regjistrime Qytet/Fshat sipas sistemeve IAL publike/jopublike



Kreu VIII

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL

Për të analizuar cilësinë e studentëve të regjistruar në ciklin e parë, dhe siç është përmendur, një rol të rëndësishëm kanë luajtur rezultatet e arritura nga kandidatët për student në ciklin e arsimit parauniversitar, është përdorur si tregues nota mesatare, e llogaritur sipas VKM Nr. 216, date 20.04.2018.

Kështu në nivel kombëtar kemi:

- Nota mesatare e të gjithë të regjistruarve **7.76**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të publike **7.81**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të jopublike **7.57**.

Në nivel kombëtar, studentët e regjistruar në IAL-të publike kanë mesatare më të lartë se studentët e regjistruar në IAL-të jopublike.


Nga të dhënat e përpunuara rezulton se:

- notën mesatare më të lartë e ka Universiteti i Mjekësisë: **9.24**;
- notën mesatare më të ulët e ka Kolegji Profesional i Tiranës (jopublik): **6.19**;

Tabela 8 – Nota mesatare e studentëve të regjistruar për çdo IAL

Universitete Publike dhe Jopublike	Numri i studentëve të regjistruar për çdo IAL	Mesatarja sipas VKM për çdo IAL
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	1039	9.24
UNIVERSITETI EPOKA	486	8.92
UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"	254	8.77
UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA	101	8.59
EPITECH (EUROPEAN INSTITUTE OF INFORMATION TECHNOLOGY)	4	8.51
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	1852	8.49
UNIVERSITETI I TIRANËS	5167	8.42
SHKOLLA E LARTË "NEHEMIAH GATEËAY"	7	8.40
KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"	130	8.29
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY (TBU)	105	8.13
KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"	141	7.89
UNIVERSITETI POLIS	170	7.85
UNIVERSITETI ALDENT	492	7.82
KOLEGJI UNIVERSITAR LUARASI	256	7.75
KOLEGJI UNIVERSITAR "Logos"	74	7.50
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	202	7.49
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	483	7.44
AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI	5	7.42
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	1142	7.42
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË	980	7.39
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	1620	7.37
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	100	7.32
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	641	7.23
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS	2313	7.22
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	299	7.22
Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë"	14	7.15
UNIVERSITETI "MESDHETAR I SHQIPËRISË"	368	7.15
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	1729	7.01
TESS (TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL)	9	6.89
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	867	6.87
UNIVERSITETI MARIN BARLETI	296	6.85
Akademia "IVODENT"	4	6.73
KOLEGJI UNIVERISTAR "REALD"	62	6.47
UNIVERSITETI "EQEREM CABEJ" GJIROKASTËR	325	6.43
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	215	6.23
KOLEGJI UNIVERSITAR ËISDOM	65	6.23
KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"	99	6.22
KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS	137	6.19

Mesatarja sipas VKM për çdo IAL



Grafik 11 Nota mesatare të studentëve të regjistruar në nivel IAL

Studentët më cilësorë në hyrje janë regjistruar në Universitetin e Mjekësisë.

Tabela 9 paraqet 25 programet e studimi, të cilat kanë studentëve të regjistruar me notën mesatare më të lartë.

Programet e studimit janë paraqitur të renditura sipas notës mesatare në rendin zbritës.

NR	Universitet Publike dhe Jopublike	Program Studimi	Numri i studentëve të regjistruar	Nota Mesatare VKM nivel program studimi
1	UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA	Sistemet e Informacionit	2	9.74
2	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e Përgjithshme	260	9.70
3	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Stomatologji	100	9.57
4	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Informatike	120	9.51
5	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Farmaci	100	9.44
6	KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"	Inxhinieri Industriale	1	9.42
7	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Arkitekturë (Arkitekt)	110	9.36
8	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Elektronike	120	9.31
9	UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA	"Administrim Biznesi" me profil "Kontabilitet"	3	9.31
10	UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë Ekonomike	250	9.27
11	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Teknikë Imazherie	50	9.25
12	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Logopedi	20	9.22
13	UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"	Mjekësi	132	9.21
14	UNIVERSITETI I TIRANËS	Financë	460	9.20
15	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Telekomunikacioni	120	9.16
16	UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Ndërtimi	23	9.14
17	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Fizioterapi	50	9.13
18	UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Kompjuterike	85	9.11
19	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Teknikë Laboratori	50	9.11
20	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Infermieri e Përgjithshme	240	9.09
21	UNIVERSITETI EPOKA	Ekonomiks	32	9.08
22	UNIVERSITETI EPOKA	Financë - Bankë	77	9.02
23	UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital	30	9.00
24	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Arkitekturë (Urbanist)	55	9.00
25	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Ndërtimi	150	8.99

Tabela 9 – Programet e studimit me mesatare më të lartë

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, studentët më cilësorë janë regjistruar në programin e studimit Mjekësi e Përgjithshme e Universitetit të Mjekësisë të Tiranës.

Kreu IX

Cilësia e studentëve të regjistruar sipas gjinisë dhe urbanizimit

Tabela 10 paraqet cilësinë e studentëve të regjistruar në nivel kombëtar, sipas gjinisë dhe urbanizimit për IAL publike/jopublike.

Tabela 10 - Nota mesatare sipas kategorizimit gjinor dhe urban

	Studentë të regjistruar total	Nota mesatare sipas VKM	Studentë të regjistruar Publike	Nota mesatare sipas VKM në IAL publike	Studentë të regjistruar IAL Jopublike	Nota mesatare sipas VKM në IAL jopublike
Femra	14179	7.95	11814	7.96	2365	7.91
Meshkuj	8074	7.42	5721	7.49	2353	7.23
Qytet	18162	7.82	13944	7.87	4218	7.65
Fshat	4091	7.49	3591	7.57	500	6.91

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, në nivel kombëtar:

- Femrat që regjistrohen në IAL kanë notë mesatare më të lartë se Meshkujt;
- Studentët që vijnë nga qyteti kanë notë mesatare më të lartë se Studentët e fshatit;
- Të njëjtat raporte kemi edhe përsa i takon studentëve të regjistruar në IAL publike dhe në IAL –të jopublike, ku femrat kanë notë mesatare më të lartë se meshkujt dhe studentët e qytetit kanë notë mesatare më të lartë se ata të fshatit.

Nëse bëjmë një krahasim sipas gjinisë dhe urbanizimit ndërmjet sistemeve IAL publike dhe jopublike rezulton se:

- femrat që regjistrohen në IAL-të publike kanë notë mesatare më të lartë se femrat që regjistrohen në IAL-të jopublike;
- i njëjti pohim vlen edhe për meshkujt;
- studentët që vijnë nga qyteti në IAL-të publike kanë notë mesatare më të lartë se studentët që vijnë nga qyteti në IAL-të jopublike;
- i njëjti pohim vlen edhe për studentët e fshatit.

Kreu X

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas segmenteve të notave mesatare për çdo IAL

Të dhëna mbi shpërndarjen e notave mesatare sipas segmenteve e përcaktuara në nivel kombëtar për IAL publike/ jopublike, në nivel program studimi.


Tabela 11 tregon numrin e studentëve të pranuar në nivel IAL-je sipas dendurive të notave mesatare në segmentet e njëpasnjëshëm të paraqitura më poshtë.

Tabela 11- Studentë të regjistruar nga secila IAL sipas segmenteve të notave

Nr	IAL	4.5-4.99	5-5.49	5.5-5.99	6-6.49	6.5-6.99	7-7.49	7.50-7.99	8-8.49	8.50-8.99	9-9.49	9.50-10	Gjithsej
1	Akademia "IVODENT"				2		2						4
2	AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI				1	1	1	1		1			5
3	EPITECH (EUROPEAN INSTITUTE OF INFORMATION TECHNOLOGY)						1			1	2		4
4	KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS	1	22	53	24	10	15	8	2	1	1		137
5	KOLEGJI UNIVERISTAR "REALD"		9	22	7	11	4		4	3	1	1	62
6	KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"				5	11	30	33	26	20	15	1	141
7	KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"				3	7	9	29	24	30	20	8	130
8	KOLEGJI UNIVERSITAR "Logos"				15	17	7	7	12	10	6		74
9	Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë"				5	1	4	3		1			14
10	KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"	1	10	46	14	10	8	8	2				99
11	KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	1	36	81	31	26	18	12	7	2	1		215
12	KOLEGJI UNIVERSITAR LUARASI				20	20	54	66	45	38	9	4	256
13	KOLEGJI UNIVERSITAR ËISDOM		9	23	8	17	3	4		1			65
14	SHKOLLA E LARTË "NEHEMIAH GATEËAY"						2	1			4		7

Nr	IAL	4.5-4.99	5-5.49	5.5-5.99	6-6.49	6.5-6.99	7-7.49	7.50-7.99	8-8.49	8.50-8.99	9-9.49	9.50-10	Gjithsej
15	TESS (TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL)		1	2	1	1		3		1			9
16	TIRANA BUSINESS UNIVERSITY (TBU)				2	8	10	29	20	20	15	1	105
17	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS		17	149	353	427	516	394	280	136	39	2	2313
18	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN		79	179	286	322	326	264	188	63	20	2	1729
19	UNIVERSITETI "EQEREM CABEJ" GJIRKASTËR	4	48	67	59	67	40	22	10	7		1	325
20	UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	4	95	119	127	135	132	121	64	49	19	2	867
21	UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË				154	214	184	195	122	79	27	5	980
22	UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR				159	236	241	228	154	87	33	4	1142
23	UNIVERSITETI "MESDHETAR I SHQIPËRISË"				81	90	80	69	34	9	5		368
24	UNIVERSITETI ALDENT				47	52	73	95	104	71	47	3	492
25	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS			16	305	337	264	263	211	162	60	2	1620
26	UNIVERSITETI EPOKA				1	2	16	31	66	113	153	104	486
27	UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS		8	35	49	72	73	99	74	43	24	6	483
28	UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS				28	40	36	33	37	21	6	1	202
29	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS						18	18	38	178	385	402	1039
30	UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS				62	64	66	53	41	11	2		299
31	UNIVERSITETI I TIRANËS				28	92	468	796	1217	1393	958	215	5167
32	UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"				6	7	11	22	23	55	89	41	254
33	UNIVERSITETI MARIN BARLETI		5	22	89	72	45	31	23	8	1		296
34	UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA		3	21	11	7	16	7	14	10	9	2	100
35	UNIVERSITETI POLIS	1	4	12	7	9	23	20	41	34	18	1	170
36	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS				60	94	119	214	338	369	471	187	1852
37	UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY				123	157	132	127	56	31	13	2	641
38	UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA				2	3	2	16	17	29	21	11	101
	Gjithsej	12	346	847	2175	2639	3049	3322	3294	3087	2474	1008	22253

SHPËRNDARJA E DËNDURIVE RELATIVE NË SEGMENTET E NOTAVE MESATARE (VKM) PËR STUDENTËT E REGJISTRUAR NË NIVEL KOMBËTAR




Grafik 12 – Shpërndarja sipas segmenteve të notave në nivel kombëtar.

Në nivel kombëtar shpërndarja e notave paraqitet grafikisht si në grafikun 12.

Në grafik tregohen përqindjet përkatëse për studentët e regjistruar me nota mesatare nga 4.5 deri në 10 të ndarë në njëmbëdhjetë segmente notash.

Rezulton se:

- 4.53 % e studentëve të regjistruar në rang kombëtar kanë notë mesatare në hyrje nga 9.50 në 10;
- 5.42% e studentëve janë regjistruar në programe studimi dy vjeçare me karakter profesional;
- 57.30% e studentëve të pranuar e kanë mesataren e notave nga 7 deri në 8.99.




Grafik 13 – Shpërndarja e dendurive relative në segmentet e notave për IAL- të publike

Nëse i shikojmë shpërndarjet sipas sistemit IAL publike dhe jopublike në segmente notash do të kemi paraqitjen grafike në grafikun 13 dhe 14:

Rezulton se:

- 4.69 % e të regjistruarve në IAL-të publike janë me notë mesatare nga 9.50 në 10.
- 41.49% të regjistruarve në IAL-të publike janë me notë mesatare nga 8 në 9.49.

SHPËRNDARJA E DËNDURIVE RELATIVE NË SEGMENTET E NOTAVE MESATARE (VKM) PËR STUDENTËT E REGJISTRUAR NË IAL JOPUBLIKE



Grafik 14 - Shpërndarja e dendurive relative në segmentet e notave për IAL- të jopublike

Në grafikun 14 tregohet shpërndarja sipas segmenteve të notave mesatare në IAL-të jopublike.

Rezulton se:

- 3.92 % e studentëve të regjistruar në IAL-të jopublike kanë nota mesatare nga 9.50-10.
- 33.49% e studentëve të regjistruar në IAL-të jopublike kanë nota nga 8 në 9.49.


Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur programet e studimit me mbi 5 studentë, me notë mesatare nga 9.5 deri në 10 të renditura në rendin zbritës. Numrin më të lartë të studentëve, në këtë interval notash, e ka program i studimit **Mjekësi e Përgjithshme** me 257 studentë.

Tabela 12 – Programet e studimit nota mesatare 9.50-10

NR	Universitet	Fakulteti	Program Studimi	Numri i studentëve të regjistruar me nota mesatare(VKM) 9.50-10
1	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Fakulteti i Mjekësisë	Mjekësi e Përgjithshme	257
2	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Stomatologji	75
3	UNIVERSITETI I TIRANËS	Fakulteti i Ekonomisë	Financë	74
4	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)	Inxhinieri Informatike	74
5	UNIVERSITETI I TIRANËS	Fakulteti i Ekonomisë	Informatikë Ekonomike	64
6	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Fakulteti i Mjekësisë	Farmaci	36
7	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU)	Arkitekturë (Arkitekt)	36
8	UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"	Fakulteti i Mjekësisë	Mjekësi	33
9	UNIVERSITETI EPOKA	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	Inxhinieri Kompjuterike	25
10	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)	Inxhinieri Elektronike	22
11	UNIVERSITETI EPOKA	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative	Financë - Bankë	21
12	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)	Inxhinieri Telekomunikacioni	20
13	UNIVERSITETI I TIRANËS	Fakulteti i Drejtësisë	Drejtësi	18
14	UNIVERSITETI I TIRANËS	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Informatikë	17
15	UNIVERSITETI EPOKA	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative	Informatikë Ekonomike	16
16	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Infermieri e Përgjithshme	12
17	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)	Inxhinieri Ndërtimi	12
18	UNIVERSITETI EPOKA	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative	Ekonomiks	10
19	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Teknikë Imazherie	9
20	UNIVERSITETI EPOKA	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital	9
21	UNIVERSITETI I TIRANËS	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Matematikë	6

	Universitet	Fakulteti	Program Studimi	Numri I studentëve të regjistruar me nota mesatare(VKM) 9.50-10
22	UNIVERSITETI EPOKA	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	Arkitekturë	6
23	UNIVERSITETI I TIRANËS	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	6
24	UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"	Fakulteti i Mjekësisë	Odontoiatri dhe Proteza Dentare	5
25	UNIVERSITETI I TIRANËS	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Biologji	5
26	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Fizioterapi	5
27	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)	Inxhinieri Mjedisi	5
28	UNIVERSITETI EPOKA	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale	Drejtësi	5
29	UNIVERSITETI EPOKA	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	Inxhinieri Ndërtimi	5

Më poshtë po paraqesim grafikisht shpërndarjen e studentëve më cilësorë nëpër programe studimi për 29 programet me mbi pesë studentë të tillë.



Grafik 15- Studentët më cilësorë sipas programeve të studimit

Kreu XI

Procesi i pranimit në programet e studimit të fushës mësuesi.

Programet e studimit të ciklit të parë të mësuesisë, që janë marrë si objekt studimi, gjithsej janë **93** nga **517** programe studimi në total.

Pra në këtë vit akademik kemi **93** programe studimi në nivel kombëtar që profilizohen në mësuesi.

Nga këto programe studimi **82** ofrohen nga IAL-të publike dhe **11** nga IAL-të jopublike.

Në të tre raundet, për programet e studimit që profilizohen mësuesi janë regjistruar gjithsej 3398 studentë (në 93 programe e studimit).

Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi

Tabela 1 paraqet numrin e studentëve të regjistruar në total dhe në programet e mësuesisë.


Tabela 1 Studentë të regjistruar në mësuesi në nivel kombëtar dhe sistem shkollimi (publik/jopublik)

	STUDENTË TË REGJISTUAR	NE %
GJITHSEJ MËSUESI	3398	15.27%
MËSUESI PUBLIKE	3278	96.47%
MËSUESI JOPUBLIKE	120	3.53%

Grafiku 1 paraqet numrin e studentëve të regjistruar në programet e tjera të studimit, në raport me programet e studimit që profilizohen në Mësuesi.

Grafiku 1 – Regjistrime në programe mësuesi në raport me programet e tjera të studimit


REGJISTRIMET NË MËSUESI BACHELOR VITI AKADEMIK 2017-2018



- **15.27%** e të regjistruarve i përkasin programeve që profilizohen në mësuesi;
- **84.23%** i përkasin të regjistruarve në programet e tjera të studimit.

Grafiku 2 paraqet në përqindje numrin të regjistruarve në programet që mund të profilizohen në mësuesi në IAL-të publike dhe ato jopublike.

Grafiku 2 – Regjistrimet mësuesi IAL publike/jopublike



- **96.47 %** e të regjistruarve janë në IAL-të publike;
- **3.53 %** në IAL-të jopublike.


Kuota të regjistruar në nivel IAL për programe që mund të profilizohen mësuesi.

Përpunimi i të dhënave, që tregon plotësimin e kuotave me studentë të regjistruar për çdo IAL në programet e studimit mësuesi paraqitet në tabelën e mëposhtme (Tabela 2).

Përqindjen më të lartë të plotësimit të kuotave të ofruara e zë:

Tabela 2 – Kuota të plotësuara me regjistrime në nivel IAL

Universiteti	Programe studimi të ofruara në mësuesi për IAL	Studentë të regjistruar në nivel IAL	Kuota Shqiptarë brenda vendit 18-19 për programe mësuesi	Kuota të plotësuar në %
UNIVERSITETI I TIRANËS	20	2130	2470	86.23%
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS	9	405	605	66.94%
KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"	3	51	109	46.79%
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	7	145	319	45.45%
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	2	36	88	40.91%
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË	8	144	493	29.21%
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	15	264	978	26.99%
UNIVERSITETI MARIN BARLETI	1	6	35	17.14%
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	14	163	973	16.75%
UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA	1	2	12	16.67%
UNIVERSITETI "EQEREM CABEJ" GJIROKASTËR	9	27	250	10.80%
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	4	25	335	7.46%
	93	3398	6667	



Grafiku 3 – Plotësimi i kuotave me regjistrime në nivel IAL programet e studimit mësuesi

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e mësuesisë

Për të analizuar cilësinë e studentëve të regjistruar në ciklin e parë në programet e studimit të cilat profilizohen në mësuesi, është përdorur si tregues nota mesatare, e llogaritur sipas VKM 216, datë 20.04.2018. Theksojmë se kriteri i notës mesatare minimale është 7, në profilet Mesuesi për vitin akademik 2018-2019.

Kështu në nivel kombëtar kemi:

- Nota mesatare e të gjithë të regjistruarve në programet mësuesi **7.98**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të publike **7.99**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të jopublike **7.89**.

Në nivel kombëtar, studentët e regjistruar në IAL-të publike në programet që profilizohen mësuesi kanë mesatare më të lartë se studentët e regjistruar në IAL-të jopublike.


Nga të dhënat e përpunuara rezultojnë se:

- notën mesatare më të lartë e ka Universiteti i Neë York: 8.41 me vetëm dy studentë të regjistruar në Psikologji;
- Universiteti i Tiranës me notë mesatare: 8.13;
- notën mesatare më të ulët e ka Universiteti “Marin Barleti” me notë mesatare 7.59;

Tabela 3 – Nota mesatare e studentëve të regjistruar për çdo IAL

UNIVERSITETI	Studente regjistruar Mesuesi	te ne	MESATARE VKM
UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA		2	8.41
UNIVERSITETI I TIRANËS		2130	8.13
KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"		51	8.02
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË		145	7.95
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS		36	7.94

UNIVERSITETI	Studente regjistruar Mesuesi	te ne	MESATARE VKM
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR		264	7.80
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE		144	7.77
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS		405	7.68
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY		25	7.64
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN		163	7.63
UNIVERSITETI "EQEREM CABEJ" GJIROKASTËR		27	7.63
UNIVERSITETI MARIN BARLETI		6	7.59



Grafiku 5- Notat mesatare të studentëve të regjistruar në nivel IAL

Tabela 4 – Paraqet njëzet programet e studimi të mësuesisë, të cilat kanë studentëve të regjistruar me notën mesatare më të lartë. Programet e studimit janë paraqitur të renditura sipas notës mesatare në rendin zbritës.

Tabela 4- Programet e studimit mësuesi me mesatare më të lartë

UNIVERSITETI	PROGRAM_STUDIMI	NR. I STUDENTËVE TË REGJISTRUAR	MESATARE SIPAS VKM PËR CDO PROGRAM
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	200	8.98
UNIVERSITETI I TIRANËS	Psikologji	109	8.69
UNIVERSITETI "EQEREM CABEJ" GJIROKASTËR	Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek	2	8.59
UNIVERSITETI I TIRANËS	Biologji	99	8.57
UNIVERSITETI I TIRANËS	GjuhëAngleze	240	8.56
UNIVERSITETI I TIRANËS	Matematikë	96	8.44
UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA	Psikologji	2	8.41
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	Matematikë- Fizikë	13	8.38
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	Matematikë	14	8.38
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	Matematikë Informatikë	23	8.34
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	Matematikë - Fizikë	9	8.27
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	Biologji -Kimi	16	8.17
KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	23	8.15
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE	Biologji	16	8.14
UNIVERSITETI I TIRANËS	Sociologji	100	8.13
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	Biologji - Kimi	8	8.13
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë-Letërsi	180	8.12
KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"	Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	14	8.11
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE	Informatike	11	8.11
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë Gjermane	120	8.11

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, studentët më cilësorë janë regjistruar në programin e studimit Informatikë të Universitetit të Tiranës

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notave mesatare

Tabela 5 tregon numrin e studentëve të pranuar në nivel IAL-je sipas dendurive të notave mesatare në segmentet e njëpasnjëshëm të paraqitura më poshtë.

Tabela 5- Studentë të regjistruar nga secila IAL sipas segmenteve të notave programet mësuesi

NR	Universitet	7-7.49	7.50-7.99	8-8.49	8.50-8.99	9-9.49	9.50-10	Gjithsej
1	UNIVERSITETI I TIRANËS	403	560	518	437	176	36	2130
2	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS	176	126	73	27	3		405
3	UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	101	78	45	28	10	2	264
4	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	85	47	17	9	4	1	163
5	UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	43	42	25	20	13	2	145
6	UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE	60	39	21	20	4		144
7	KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"	11	15	12	11	1	1	51
8	UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	13	8	6	5	4		36
9	UNIVERSITETI "EQEREM CABEJ" GJIROKASTËR	11	11	3	2			27
10	UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	11	10	3			1	25
11	UNIVERSITETI MARIN BARLETI	3	2	1				6
12	UNIVERSITY OF NEË YORK TIRANA		1			1		2
	Gjithsej	917	939	724	559	216	43	3398


Në nivel kombëtar shpërndarja e notave paraqitet grafikisht si në grafikun 6.

Në grafik tregohen përqindjet përkatëse për studentët e regjistruar me nota mesatare nga 7 deri në 10 të ndarë në tetë segmente notash.

Grafiku 6- Shpërndarja sipas segmenteve të notave në nivel kombëtar, mësuesi.

TË REGJISTRUAR NË % SIPAS NOTËS MESATARE VKM SIPAS SEGMENTEVE TE NOTAVE PROGRAME MËSUESI

■ 7-7.49 ■ 7.50-7.99 ■ 8-8.49 ■ 8.50-8.99 ■ 9-9.49 ■ 9.50-10




Rezulton se :

- 1.27 % e studentëve të regjistruar në programet e mësuesisë në rang kombëtar kanë notë mesatare në hyrje nga 9.50 në 10;
- 75.93 % e studentëve të regjistruar në programet e mësuesisë në rang kombëtar kanë notë mesatare në hyrje nga 7.00 në 8.49;

Nëse i shikojmë shpërndarjet sipas sistemit IAL publike dhe jopublike në segmente notash do të kemi paraqitjen grafike në grafikun 7:
Rezulton se:

- 1.25 % e të regjistruarve në IAL-të publike mësuesi janë me notë mesatare nga 9.50 në 10.
- 44.39% të regjistruarve në IAL-të publike mësuesi janë me notë mesatare nga 8 në 9.49.




Grafik 7 – Shpërndarja e dendurive relative në segmentet e notave për IAL- të publike mësuesi

Në grafikun 8 tregohet shpërndarja sipas segmenteve të notave mesatare në IAL-të jopublike.

Rezulton se:

- 1.67% e studentëve të regjistruar në IAL-të jopublike mësuesi kanë nota mesatare nga 9.50-10.
- 36.67 % e studentëve të regjistruar në IAL-të jopublike mësuesi kanë nota nga 8 në 9.49.

Grafik 8 - Shpërndarja e dendurive relative në segmentet e notave për IAL- të jopublike mësuesi



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur programet e studimit me, me notë mesatare nga 9.5 deri në 10 të renditura në rendin zbritës. Numrin më të lartë të studentëve, në këtë interval notash, e ka program i studimit Informatikë në Universitetin e Tiranës me 17 studentë.

Tabela 12 – Programet e studimit nota mesatare 9.50-10

UNIVERSITETI	PROGRAM_STUDIMI	Numri i studentëve të regjistruar me note mesatare (VKM) 9.50-10
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	17
UNIVERSITETI I TIRANËS	Matematikë	6
UNIVERSITETI I TIRANËS	Biologji	5
UNIVERSITETI I TIRANËS	GjuhëAngleze	3
UNIVERSITETI I TIRANËS	Psikologji	3
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	Informatikë	2
KOLEGJI UNIVERSITAR "Bedër"	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	1
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	Biologji - Kimi	1
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	Matematikë- Fizikë	1
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	Matematikë Informatikë	1
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë Gjermane	1
UNIVERSITETI I TIRANËS	Sociologji	1
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	Mësuesi për Arsimin Fillor	1

Më poshtë po paraqesim grafikisht shpërndarjen e studentëve më cilësorë nëpër programe studimi, të cilat mund të profilizohen në mësuesi.

Grafik 9- Studentët më cilësorë sipas programeve të studimit mësuesi

